VENDIMI
Nr. 770, datë 15.12.2021

PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË SHKOLLËS 9-VJEÇARE "DEMOKRACIA", VALIAS I RI, BASHKIA KAMZË, DHE CAKTIMIN E BASHKISË KAMZË SI NJËSI ZBATUESE

(ndryshuar me vendimin nr. 789, datë 12.12.2022)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" e "iii", 16, dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të shkollës 9-vjeçare "Demokracia", Valias i Ri, Bashkia Kamzë, në masën 387 798 722 (treqind e tetëdhjetë e shtatë milionë e shtatëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e njëzet e dy) lekë pa TVSH.

2. Bashkisë Kamzë, në buxhetin e vitit 2021, i transferohet fondi në formën e transfertës së pakushtëzuar, në masën 77 559 744 (shtatëdhjetë e shtatë milionë e pesëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e dyzet e katër) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të shkollës 9-vjeçare "Demokracia", Valias i Ri, Bashkia Kamzë, i cili do të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2021.

2/1. Bashkisë Kamzë, në buxhetin e vitit 2022, i transferohet fondi në formën e transfertës së pakushtëzuar, në masën 101 000 000 (njëqind e një milionë) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të shkollës 9-vjeçare "Demokracia", Valias i Ri, Bashkia Kamzë, i cili do të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022.

3. Bashkia Kamzë caktohet si njësi zbatuese për financimin e rindërtimit të shkollës 9-vjeçare "Demokracia", Valias i Ri, Bashkia Kamzë, sipas pikave sipas *pikave 1, 2 dhe 2/1, të* këtij vendimi.

4. Ngarkohen zëvendëskryeministri dhe ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Kamzë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj